

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I FINANCËS
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 6004/7 Prot

Tiranë, më 02/12/2024

Lënda: Përgjigje shkresës Nr.1859/12, datë 20.11.2024 “Kërkesë për informacion në lidhje me Aplikimin e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025-2027”

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.1859/12, datë 20.11.2024 “Kërkesë për informacion në lidhje me Aplikimin e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025-2027”, lutem gjeni informacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

1. Nga analizimi i tabelës “Vlerësime 2023 – 2027” të pasqyruar në faqen nr. 2 të informacionit plotësues, të përcjellë përmes korrespondencës së sipërcituar, evidentohet se realizimi i zërit “Të ardhura të tjera” është 5,371 milion lekë për vitin 2023 si dhe 803 milion lekë për 6 – mujorin e parë të vitit 2024. Cilat llogari të të ardhurave kategorizohen nën këtë zë? Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara për vitin 2023 të pasqyruar në këtë tabelë me të ardhurat e realizuara të paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara të po së njëjtës periudhë ushtrimore, rezulton se vlerat nuk përputhen. Sa konstatuar më lart, lutem paraqisni sqarimet Tuaja.

Sqarimi: Në lidhje me tabelën të cilën Ju referoni, ju bëjmë me dije se mënyra e raportimit të treguesve kryesorë të pasqyruar ka për qëllim raportimin përmbledhës të realizimit dhe/ose pritshmëritë dhe parashikimet e treguesve kryesorë të OST sh.a.. Të dhënat e prezantuara në këtë tabelë për treguesit faktik janë në përputhje të plotë me Pasqyrat Financiare Individuale të OST sha të mbyllura dhe audituara për vitin 2023.

Për vlerën e pasqyruar në zërin “Të ardhura të tjera”, lutem gjeni detajimin sipas tabelës si më poshtë vijon:

Llogaria	Fakti	
	31.12.2023	30.06.2024
Rimarje provizini	2,581,440,780	
Te ardhurat financiare	2,749,250,814	783,748,440
Te ardhura nga shitja e skrapit	10,826,193	
Te ardhura nga qeraja	456,742	74,975
Te ardhura nga penalitetet	120,905	117,505
Te ardhura nga komunikimi nderkufitar (CNMLA Entsoe)	3,743,577	783,461
Te ardhura nga lidhjet e reja	4,000,000	3,500,000
Te ardhura nga tarifet e mbikqyrjes	6,200,000	14,500,000
Te ardhura nga hyrjet ne magazine	4,000,012	
Te ardhura te ndryshme	11,281,407	338,918
Total	5,371,320,430	803,063,298

Ju bëjmë me dije se krahasimi ndërmjet të ardhurave të realizuara për vitin 2023 të pasqyruar në këto tabele duhet të bëhet me Pasqyrat Financiare Individuale të OST sh.a. të po të njëjtes periudhe ushtrimore pasi rezultatet e pasqyruara në aplikimin për tarifen 2025-2027 nuk përfaqësojnë të dhëna apo tregues të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të OST sh.a.

Gjithashtu zërat si “Rimarje provizioni” dhe “Te ardhurat financiare” paraqiten në vlerë neto në pasqyrat financiare ndërsa në analizën e përcjelle nga ana jone për realizimin e treguesve ekonomiko-financiar shfaqen në formë të detajuar për të ofruar një pasqyrim me të qartë të të dhënave. Në mënyrë të detajuar këto dy zëra i gjëni si në tabelat më poshte:

Llogaria	31.12.2023
Rimarje provizioni nga renia në vlerë e aseteve	2,581,440,780
Humbje nga renia në vlerë e aseteve	(35,532,256)
Fitim/Humbje nga renia në vlerë e aseteve net në pasqyrat financiare	2,545,908,523

Llogaria	31.12.2023
Te ardhurat ngajnteresat dhe kursi i kembimit	2,749,250,814
Humbje nga kursi i kembimit	(475,095,765)
Te ardhurat e shpenzimet financiare net në pasqyrat financiare	2,274,155,049

2. Referuar zërit ‘Shpenzime të tjera personeli’ konstatohet se për vitin 2024 është planifikuar të realizohet në vlerën 99 milion lekë. Ndërkohë, përgjatë periudhës rregullatore 2025 - 2027 parashikimi i këtij shpenzimi arrin deri në 117 milion lekë, shprehur ndryshe me një trend në rritje deri në 18%. Cilat llogari të shpenzimeve klasifikohen nën këtë zë?

Sqarimi: Për vlerën e pasqyruar në zërin “Shpenzime të tjera personeli”, lutem gjëni detajimin sipas tabelës si më poshtë vijon:

Llogaria	Fakti			Parashikim 2024-2027		
	2022	2023	I pritshmi 2024	2025	2026	2027
Shperblime per performance/paga 13	29,359,000	5,860,000	91,467,670	101,412,123	104,454,487	107,588,122
Shpenzime page per doktorature	1,440,000	160,000	1,859,689	2,061,877	2,123,733	2,187,445
Shpenzime per lindje femije	3,800,000	400,000				
Shpenzime per daljet ne pension	3,304,000	3,956,000	3,574,125	3,962,707	4,081,588	4,204,036
Shpenzime per rast vdekje	1,894,440	400,000				
Shperblim per leje vjetore te pakryer	2,456,875	1,426,483	2,607,329	2,890,800	2,977,524	3,066,849
Total	42,254,315	12,202,483	99,508,813	110,327,507	113,637,332	117,046,452

Vlera e parashikuar për vitin 2025, reflekton ndryshimet e strukturës së pagave të punonjësve të OST sh.a., ndryshime të cilat kanë hyrë në fuqi në Maj të vitit 2024. Ndërsa vlera e parashikuar e këtij zëri, për vitet 2026; 2027 mban në konsideratë një rritje rreth 3% në vit, normë e cila reflekton indeksimin e pagave të punonjësve të Ost sh.a.

3. Në informacionin plotësues të përcjellë në ERE me shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, është pasqyruar realizimi i zërit shpenzime ‘materiale të para’, për periudhën janar - gusht 2024, për secilën njësi operative, si dhe parashikimi i totalit të këtij grup shpenzimi për pjesën e mbetur të vitit 2024 dhe periudhën rregullatore 2025 – 2027. Në lidhje me këtë kosto, keni sqaruar se parashikimi i kryer është bazuar mbi të dhënat historike të realizimit të këtij zëri si dhe kontratave të reja, të cilat OST sh.a ka parashikuar të realizojë gjatë vitit 2025. Referuar sa më sipër, konstatohet se kostot faktike të 8-mujorit 2024 janë në vlerën 49 milion lekë dhe për periudhën e mbetur pritet që ky shpenzim të realizohet në vlerën 70 milion lekë. Krahasuar me realizimin e vitit 2023, rezulton se ky shpenzim ka pësuar një rritje me rreth

13.5 %. Më tej, në aplikimin e paraqitur evidentohet se për vitin 2025 ky shpenzim është parashikuar në vlerën 167 milion lekë ose shprehur ndryshe 61% më i lartë se sa realizimi i vitit 2023. Sa më sipër konstatuar, kërkohet dhënien e shpjegimeve si dhe paraqitjen e dokumenteve justifikues për procedurat në proces që lidhen me këtë zë sa i takon dhe rritjes se parashikuar në vlerat e konstatuara sa më sipër.

Sqarimi: Shpenzimet e materialeve përfshijnë të gjitha materialet që përdoren në mirëmbajtjen e linjave, nën-stacioneve, godinave, karburanti dhe kancelaritë. Në llogaritjen e vlerës së këtij zëri janë marrë në konsideratë realizimi i deritanishëm i zerave të shpenzimeve si dhe kontratat e reja të cilat OST ka parashikuar të realizojë gjatë vitit 2025 ku ndër me me impakt mund të përmendim:

- Blerje pajisjesh për nën-stacione në vlerën 50,480,700 lekë pa tvsh;
- Blerje e pjesëve të këmbimit dhe materialeve për mirëmbajtjen e linjave të transmetimit në vlerën 88,877,660 lekë pa tvsh
- Blerje karburanti në vlerën 35,369,458 lekë pa tvsh
- Blerje karrige për nevojat e OST në vlerën 8,652,000 lekë pa tvsh.;

Vlera e parashikuar për vitin 2025, reflekton nevojat për këtë zë shpenzimesh ku pjesa më e madhe e këtij zëri ka të bëjë me nevojat për materialet e mirëmbajtjes së linjave dhe nën-stacioneve. Ndërsa vlera e parashikuar e këtij zëri, për vitet 2026; 2027 mban në konsideratë një indeksim rreth 3% në vit. Në vlerësimin tonë, vlerat dhe zërat e parashikuara të shpenzimeve për vitin 2025, duhet të analizohen sipas kërkesës së natyrës së domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit dhe jo detyrimisht duke i vlerësuar me ndryshimin në % nga një referencë e mëparshme. Megjithatë, edhe në këtë rast, vlerësojmë se baza krahasuese e ndryshimit/ve vjetore duhet të referohet me vitin paraardhës.

4. Për shpenzimin 'Blerjen e shërbimeve ndihmëse' rezulton se për vitin 2023 është realizuar në vlerën 806 milion lekë, ndërkohë që për vitin 2024 planifikohet në vlerën 1,101 milion lekë (një rritje prej 37%). Më tej, në vitin e parë të periudhës rregullatore 2025-2027 ky zë parashikohet në vlerën 1,759, ose shprehur ndryshe 118% më i lartë se realizimi i vitit 2023. Në lidhje me kostot ex-ante, në shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4, datë 09.10.2024, keni argumentuar se trendi në rritje i këtij shpenzimi diktohet nga rritja e devijimeve në balancën e sistemit si pasojë e integritetit të burimeve të rinovueshme, të cilat kanë luhatur të konsiderueshme të prodhimit të tyre. Nisur nga argumenti i dhënë nga ana Juaj, konkretisht cilat janë evidencat dhe të dhënat e marra në konsideratë në arritjen e një konkluzioni të tillë? Bazuar në eksperiencën e viteve të mëparshme, a janë kryer përllogaritje dhe vlerësime se sa pika lidhje janë dhënë për këto burime të rinovueshme në raport me ato që kanë hyrë në operim? Cilat janë ngjarjet faktike që kanë ndodhur gjatë periudhës 2022-2024 që ju shtynë të parashikoni dyfishimin e këtij shpenzimi për periudhën e ardhshme rregullatore 2025-2027? Lutemi, evidentoni bashkë me shpjegimet përkatëse përllogaritjet dhe referencat mbi kostot e parashikuara.

Sqarimi: Aktualisht, OST prokuron vetëm rezervat automatike të rivendosjes së frekuencës (\pm aFRR) për rritje dhe ulje. Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës (FCR), të njohura si rezerva primare, nuk prokurohen nga OST pasi asnjë nga OSHB-të nuk plotëson kushtet teknike për ofrimin e këtij shërbimi. Përsa i përket rezervave zëvendësuese manuale (mFRR dhe RR), këto nuk janë prokuruar deri më tani, pasi kërkesat për balancim janë plotësuar përmes

(\pm aFRR). Në të ardhmen, prokurimi i rezervave mFRR dhe RR do të varet nga zhvillimet dhe ndryshimet në Sistemin e Transmetimit, duke marrë parasysh rreziqet operationale që ndikojnë në sigurinë e sistemit, si regjimet e larta të eksportit apo importit. Këto rezerva janë të nevojshme për të reduktuar ndikimin e incidenteve dhe për të parandaluar përhapjen e problemeve në sistemet fqinje të transmetimit, duke u bazuar në kriterin e mbulimit të gjeneratorit më të madh të angazhuar në operim. Rezerva (\pm aFRR) që prokurohet dhe ndikon në tarifë, përlllogaritet nga OST në përputhje me Manualin e Operimit të ENTSO-E dhe duke marrë parasysh vlerat historike të devijimeve. Kërkesa për kapacitetin rezervë përditësohet çdo vit, dhe rritja e rezervave diktohet kryesisht nga rritja e devijimeve në balancën e sistemit si pasojë e integritit të burimeve të rinovueshme, të cilat kanë luhatje të konsiderueshme në prodhimin e tyre.;

5. *Në zbatim të Rregullave të Tregut të Balancimit, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106/2020, si dhe duke marrë në konsideratë detyrat e lëna në kuadër të vendimit të bordit të ERE-s nr. 72/2022, cilat janë masat që OST sh.a. ka ndërmarrë në lidhje me rishikimin e komponentëve nxitës, me qëllim garantimin e neutralitetit financiar në lidhje me tregun e balancimit? Paraqisni shpjegimet Tuaja.*

Sqarimi: OST, në cilësinë e operatorit të sistemit, është palë qendrore për qëllim të mekanizmit balancues dhe është përgjegjëse për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht dhe të administrojë procesin e llogaritjeve financiare. Si rrjedhojë çdo palë përgjegjëse balancuese deklaron në OST programe të balancuara dhe duke u bazuar në matjet faktike për secilin llogariten disbalancat e shkaktuara.

Bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, Neni 12.3 përkatësisht pika 3.5 “Komponentja Nxitëse”, parashikohet korrektimit i cmimeve të disbalancave nëpërmjet një komponente nxitëse, për të cilën OST ka hartuar një procedure dhe ju është bërë me dije palëve që operojnë tregun.

Përsa më sipër OST nuk parashikon të ardhura nga tregu balancues pasi bazuar në rregullat në fuqi incetivon Palët Përgjegjëse Balancuese për të nominuar programe të balancuara. Dhe konform parashikimeve të rregullave nuk prezumohet në asnjë rast që përdorimi i kësaj komponente nxitëse të garantojë një neutralitet financiar përse i përket portofolit të balancimit që menaxhohet nga OST si palë qendrore për qëllim të mekanizmit balancues.

Gjithësesi, OST po ndërmerr masa sikurse ju janë bërë me dije të cilat do jenë ndihmuese në uljen e volumit të disbalancave në Sistemin e Elektroenergjitik duke siguruar një sistem të balancuar dhe në këtë mënyrë do synohet arritja e neutraliteti në terma financiar të mekanizmit të balancimit.

Përgjatë periudhës së ardhshme rregullatore, parashikohet se gjatë vitit 2025 do të jetë në operim Tregu Brenda Ditës në Bursën Shqiptare të Energjisë, do të implementohet rezolucioni 15 minutësh në proceset e tregut balancues. Këto ngjarje do të ndikojnë në saktësinë e planifikimeve të programeve nga palët e tregut. Në çdo rast OST duhet të marrë në konsideratë të gjithë skenarët e mundshëm që ndikojnë negativisht në sigurinë e operimit të sistemit, duke parashikuar një rritje të sasisë për rezervat balancuese të nevojshme për mbulimin e devijimeve të pritshme, përgjatë periudhës së ardhshme rregullatore.

6. Lidhur me zërin “Menaxhim kongjestioni në ridispecerim” për vitin 2025 ky shpenzim është parashikuar në vlerën 654 milion lekë. Referuar aktivitetit të OST sh.a. gjatë periudhës rregullatore 2022 – 2024, a jeni gjendur në rrethanat e nevojës për kontraktimin e shërbimit të kërkuar? Nëse po, cilat janë kostot faktike të identifikuara në lidhje me këtë shërbim, të cilat kanë shërbyer si referencë për parashikimin e këtij zëri për periudhën e ardhshme rregullatore? Lutemi, shpjegimet të shoqëruara me referenca dhe përlllogaritjet sa i takon këtij shpenzimi.

Sqarimi: Menaxhimi i kongjestioneve me ridispecerim është bërë detyrim për OST që nga data 1 prill 2021, me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Sipas nenit 103, pika 1, germa E e të Kodit të Transmetimit, OST sh.a. mund të zbatojë menaxhimin e kongjestioneve përmes ridispecerimit të energjisë elektrike nga centralet prodhuese, për të siguruar funksionimin e sigurt të sistemit dhe furnizimin pa ndërprerje, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike.

Ligji 43/2015 (i përditësuar), neni 51, pika 1, germa b, përcakton se prodhuesit kanë të drejtë të shesin energjinë elektrike dhe të ofrojnë shërbime ndihmëse dhe balancimi në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE. Në pikën 2, germa c të nenit 51, prodhuesit kanë detyrim të sigurojnë shërbime ndihmëse për operatorin e sistemit, në përputhje me rregullat e tregut.

Për të përmbushur këtë detyrim, OST sh.a. ka kërkuar në periudhat e mëparshme njohjen dhe përfshirjen e këtyre kostove në tarifën e transmetimit, për të siguruar fondet e nevojshme për kontraktimin e këtij shërbimi. Deri tani, këto kosto nuk janë njohur apo përfshirë në tarifën e transmetimit. OST sh.a. e konsideron të domosdoshme njohjen e këtyre kostove në tarifë për të përmbushur detyrimet e saj.

7. Në lidhje me Marrëveshjen e ndërsjellë OST sh.a. – OSSH sh.a. për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, cila është gjendja aktuale e detyrimeve të mbetura? Si janë përdorur fondet e marra përgjatë periudhës rregullatore 2022 – 2024? Lutemi, përcillni argumentet si dhe shpjegimet përkatëse.

Sqarimi: Gjendja aktuale e detyrimeve të mbetura nga “Marrëveshja për pagesën e detyrimeve të prapambetura” deri me 31/10/2024 rezulton në shumën 8,609,229,200 leke. Fondet e arketuara përgjatë periudhës rregullatore 2022-2024 janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve që OST sh.a. ka ndaj shoqërisë KESH sh.a. në bazë të “Marrëveshjes për pagesën e detyrimeve të prapambetura” të firmosur ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. me datë 05/10/2021.;

8. Referuar aplikimit si dhe korrespondencës nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4, datë 09.10.2024, OST sh.a. kërkon të realizojë investime për periudhën e ardhshme rregullatore 2025 - 2027, ku projektet e planifikuara për vitin 2026 dhe 2027 të financohen tërësisht me fondet e vetë shoqërisë. Në lidhje me këtë çështje, përse është konsideruar kjo metodë financimi? A është kryer një vlerësim paraprak kosto- përfitim i kësaj metode financimi duke e krahasuar me format e tjera të financimit? Paraqisni argumentet tuaja mbi kryerjen e investimeve me fondet e shoqërisë OST sh.a. krahasuar me kryerjen e investimit me fonde të huaja dhe e raporteve të diversifikimit të investimit kapital+borxh. Lutemi, analizat dhe vlerësimet tuaja bashkë me argumentet përkatëse.

Sqarimi: Për sa i përket burimit të financimeve për realizimin e investimeve që OST sh.a. parashikon të realizojë për periudhën e ardhshme rregullatore, nga ana e OST sh.a. janë konsideruar të finalizohen dhe të realizohen gjatë kësaj periudhe, ato investime të cilat kanë angazhime financiare në format e huave të marra.

Për vitet në vijim (2026-2027), nga ana e Ost sh.a. nuk ka fonde të huaja të angazhuara për realizimin e investimeve dhe realizimi i projekteve të investimeve të domosdoshme, është parashikuar të realizohet me fondet e OST sh.a..

9. Në aplikimin e paraqitur nga OST sh.a janë konsideruar: (i) WACC e njëjtë me normën e miratuar nga ERE prej 2.28% (AroE= 1.8%) dhe (ii) WACC me normën prej 4.81% (AroE= 4.75%). Mbi cilat vlerësime jeni mbështetur për përcaktimin e normës së kthimit në kapital prej AroE = 4.75%? Paraqisni referencat përkatëse. Po kështu, në lidhje me përllogaritjen e kostos së borxhit sqaroni komponentët e përllogaritjes së normës 2.7%, bashkë me përllogaritjet përkatëse.

Sqarimi: Ne lidhje me normën e kthimit në kapital prej AroE = 4.75%, duke u nisur nga treguesit faktikë financiarë për vitin ushtrimor të mbyllur me 31.12.2023, janë bërë vlerësimet sipas tabelës së mëposhtme:

	Versioni 1	Versioni 2
$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$	2.28%	4.81%
ES - Objektivi per raportin e kapitalit te vet ne RAB	72.91%	72.91%
T - Norma e takses se korporates	15.00%	15.00%
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	1.80%	4.75%
DS - Objektivi per raportin e borxhit ne RAB	27.09%	27.09%
CoD - Kosto e borxhit	2.71%	2.71%

Ku:

ES – Norma faktike e rezultuar sipas pasqyrave Viti 2023;

T – Norma e Tatim fitimit;

DS – Norma faktike e rezultuar sipas pasqyrave Viti 2023;

ARoE – Norma korresponduese respektive per treguesit faktik të realizuar e cila reflekton tarifën mesatere të miratuar nga ERE prej 0.85 lekë/kWh. Kjo normë është derivat i dalë nga elementët e tjerë faktik të rezultuar;


CoD – Norma faktike e rezultuar sipas pasqyrave Viti 2023: kostot e borxhit/Detyrimet Afatgjata;

Nga ana e OST sh.a., është vlerësuar në mënyrë racionale kërkesa për normën e WACC të marrë në konsideratë në aplikimin e bërë për tarifën e nevojshme të transmetimit.

Duke u nisur nga të dhënat e normës së WACC për OST-të e vëndeve të tjera, rezulton që Shqipëria ka normën më të ulët të WACC të njohur për tarifën e transmetimit.

Në grafikun e mëposhtëm tregohen këto vlera:

Norma e WACC per Kompanite e Transmetimit te Energjise (%)



Nisur nga këto të dhëna, Norma mesatare e WACC, rezulton të jetë 6.34%.

10. Lidhur me 'Parashikimin e kërkesës së energjisë elektrike' që pritet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit, në shkresën tonë me nr. 1859/2, të datës 20.09.2024, ju është kërkuar paraqitja e komunikimeve dhe rakordimeve të zhvilluara mes Jush dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit (FTL sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. si dhe Klientët e Kualifikuar). Në përgjigjen Tuaj të përcjellë me shkresën nr. nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4, datë 09.10.2024, janë bashkëlidhur vetëm komunikimet e kryera në formë elektronike me FTL sh.a, KESH sh.a dhe Klientët e Kualifikuar.

Referuar bilancit energjitik të vitit 2024 dhe të periudhës rregullatore 2025 – 2027 (të paraqitur në Aplikim), parashikohet që sasia e energjisë elektrike e transmetuar për OSHEE sh.a të jetë në rënie ndërsa energjia elektrike e transmetuar për Klientët e Kualifikuar parashikohet në rritje. Nisur nga argumentat e dhëna prej Jush, këta tregues marrin në konsideratë integrimin e parqeve fotovoltaike që pritet të futen në operim si dhe vetëprodhuesit, të cilët prodhojnë energji elektrike që konsumohet kryesisht në rrjetin e shpërndarjes. Sa më sipër, lutemi të përcillni gjithashtu komunikimet e zhvilluara mes Jush dhe FSHU sh.a. si dhe Furnizuesit e tregut mbi të cilat është mbështetur parashikimi për energjinë që pritet të transmetohet në periudhën e ardhshme rregullatore.

Sqarimi: Përsa kërkohet nga ana juaj gjeni, komunikimet e vitit 2024 me përdoruesit e SEE jane percjelle ne shkresen e meparshme mbi kete objekt.;

11. Në Aplikimin e Tarifës së transmetimit për periudhën 2025 - 2027, trendi i konsumit të energjisë parashikohet me rënie mesatarisht 0.26% për secilin vit të periudhës rregullatore. Ndërkohë, nga të dhënat ex-post të konsumit në vitet paraardhëse, vërehet se konsumi në

2023 krahasuar me 2022 ka pësuar një rënie prej 1,92 %. Më tej, konsumi i periudhës së realizuar të 2024 krahasuar me vlerën e 2023 rezulton sërish me një rritje prej 4,26 %. Gjithashtu, evidentohet një diferencë e theksuar sa i takon energjisë që pritej të transmetohej nga OST sh.a. në aplikimin e saj për periudhën rregullatore 2022-2024 kundrejt realizimit faktik si dhe pritshmërisë për vitin 2024. Lutemi, dhënien e sqarimeve se cilat janë arsyet e evidentuara nga OST sh.a lidhur me ndryshimin e energjisë së transmetuar në këto përmasa (fenomene teknike apo jo teknike) në periudhën rregullatore 2022-2024, (mbi të cilat janë mbështetur parashikimet sa i takon uljes së konsumit të energjisë në periudhën e ardhshme rregullatore), nga krahasimi i të cilave rezulton mesatarisht një diferencë prej 550 GWh ose 7% sikurse evidentohet në tabelën në vijim:

Sqarimi: Në lidhje me shqetësimin tuaj të shprehur në pikën 11 të shkresës, sqarojmë se:

Detajimet në bilancet e energjisë nuk tregojnë konsumin. Bilanci i energjisë detajon hyrjet dhe daljet e flukseve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për një periudhë të caktuar. Përsa i përket sasisë së konsumit në rënie për vitet 2026 dhe 2027, OST ka marrë në konsideratë gjatë vlerësimit integrimin e parqeve fotovoltaike që pritet të futen në operim, si dhe "vetëprodhuesit" që prodhojnë energji elektrike, e cila konsumohet kryesisht në rrjetin shpërndarës.;

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST sh.a.

Skërdi Drenova

